5. Mbështetur në analizën e kryer nga grupi i punës i ngritur për studimin e zonës që do të zhvillohet për strehim, sipas pikës 2, të këtij kreu, me qëllim shtimin e fondit publik të banesave sociale, njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nëse ka mundësi financiare për ta realizuar me të ardhurat e veta zhvillimin e zonës, ose ka nevojë për bashkëpunim dhe bashkëfinancim nga subjekte private ose nga buxheti i shtetit.

**II. Procedura e përzgjedhjes së subjektit privat në rastin e shkëmbimit të truallit në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore me sipërfaqe ndërtimi**

1. Procedura në rastin e financimit të banesave nga subjekti privat në truallin në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim shkëmbimin e vlerës së truallit me sipërfaqe ndërtimi, sipas shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, kryhet vetëm me konkurrim, për:

a) ndërtimin e objektit sipas projektit të parapërgatitur nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose;

b) projektin e ndërtimit/zhvillimit të përgatitur nga subjekti privat së bashku me ndërtimin e objektit.

2. Procedura konkurruese synon që trualli në pronësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore të shkëmbehet me sipërfaqe ndërtimore sipas vlerës më të lartë të shkëmbimit, kur ndërtimi realizohet me financim të subjekteve private.

3. Thirrja për konkurrim botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në website-in e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe përmban, si më poshtë vijon:

a) qëllimin e thirrjes, ku jepet përshkrimi i ndërtimit dhe projektit që synohet të realizohet,

b) objektin e kontratës dhe kohëzgjatjen e saj;

c) kërkesat për kualifikim në lidhje me kapacitetet administrativo-ligjore, teknike dhe ekonomike-financiare;

ç) specifikimet lidhur me projektin në rastin kur është parapërgatitur nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose kur kërkohet të përgatitet nga subjekti privat;

d) vendndodhjen e zonës ku do të realizohet investimi dhe kushtet zhvillimore, sipas kuptimit të legjislacionit mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

dh) përqindjen e llogaritur të sipërfaqes së ndërtimit që i takon njësisë së vetëqeverisjes vendore në këmbim të truallit në pronësi të saj, llogaritur sipas shkronjës "ç", të pikës 4, të kreut I, të këtij vendimi, e cila përdoret si nivel 'dysheme' në vlerësimin e ofertave;

e) formularin e ofertës, i cili plotësohet nga kandidatët/ofertuesit dhe përmban konfirmimin e kandidatit/ofertuesit se ai/ajo e ka pranuar përmbajtjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe deklarimin se çdo e dhënë e rreme përbën shkak ligjor për skualifikim të kandidatit/ofertuesit;

ë) vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;

f) metodologjinë e vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, si dhe kriteret e shpalljes së fituesit;

g) informacionin për sa i përket procedurës së rishikimit dhe dorëzimit të ankesave.

4. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e zhvilluesit, ku përcaktohen:

a) njësia përgjegjëse për organizimin e procedurave konkurruese dhe përgatitjen e dokumentacionit, që përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me të paktën 1 (një) jurist në përbërjen e saj; dhe

b) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (Komisioni), i cili përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë: një inxhinier/arkitekt, një ekonomist, një jurist, dhe një specialist nga struktura përgjegjëse për strehimin. Anëtarë të Komisionit caktohen persona të cilët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Kryetar i Komisionit është nënkryetari i bashkisë.

5. Kriteret për kualifikim janë të grupuara, si më poshtë vijon:

A. Kriteret administrativo-ligjore:

a) Çdo kandidat/ofertues për të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit do të kualifikohet pasi të dorëzojë ekstraktin e Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, si dhe ekstraktin mbi historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimore, me qëllim që të bëhet verifikimi për përmbushjen e kritereve të mëposhtme:

i. të mos jetë në proces falimentimi dhe likuidimi të shoqërisë tregtare;

ii. të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

iii. të mos jetë debitor për pagimin e detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

B. Kriteret teknike që lidhen me eksperiencën në ndërtime për banesa dhe objekte të ngjashme të realizuara dhe të përfunduara me sukses; licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve sipas objektit të kontratës; kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve.

C. Kriteret financiare që lidhen me qëndrueshmërinë financiare të subjektit konkurrues, e cila vërtetohet me kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse edhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit.

6. Kriteret për vlerësim janë:

a) kur NJVV-ja kërkon në thirrjen për konkurrim që projekti të paraqitet së bashku me ofertën për këmbimin e truallit me ndërtim vlerësimi bëhet, si më poshtë:

i. deri në 30 (tridhjetë) pikë për zgjidhjen teknike, ku vlerësohen zgjidhjet e qëndrueshme dhe efiçente për ndërtimin dhe shfrytëzimin e objektit; shkalla e performancës energjetike të godinës; përdorimi i materialeve dhe teknologjive qarkulluese/ricikluese;

ii. jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) pikë për përqindjen më të lartë të shkëmbimit të vlerës së truallit në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore me sipërfaqe ndërtimi.

b) kur projekti është hartuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore vlerësimi bëhet për

përqindjen më të lartë të shkëmbimit të sipërfaqes së ndërtimit që do të sigurohet në këtë formë bashkëpunimi.

7. Njësia përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të konkurrimit që do të përdoren gjatë procedurave të përzgjedhjes së zhvilluesit, parashikuar në shkronjën "a", të pikës 4, të kreut II, përgatit dokumentacionin e nevojshëm për konkurrim, si më poshtë vijon:

a) formulari i sigurimit të ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet, i cili parashikon masën prej 3 (tre) për qind të vlerës së truallit, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Sigurimi i ofertës duhet të jetë pa kushte dhe i vlefshëm për 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave;

b) formulari i njoftimit të fituesit. Pas përzgjedhjes kandidati/ofertuesi fitues njoftohet me shkrim duke u informuar për emrin dhe adresën e saktë të kandidatit/ofertuesit të shpallur fitues, përshkrimin e projektit apo shërbimit të zhvilluesit, kohëzgjatjen e kontratës dhe vlerën e kontratës, termat e kontratës, emrat dhe vlerën e kandidatëve/ofertuesve të tjerë, emrat e kandidatëve/ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, si dhe kërkesën për fillimin e negociimit të kontratës, me kusht që të jetë bërë sigurimi i kontratës në masën prej 10 (dhjetë) për qind të vlerës së kontratës;

c) formulari i skualifikimit të ofertuesve përmban shkaqet kur një kandidat/ofertues nuk do të kualifikohet në procedurën konkurruese sepse oferta është e pavlefshme;

ç) formulari i publikimit të termave kryesorë të kontratës me zhvilluesin përmban kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, objektin e kontratës dhe të drejtat e detyrimet që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës, të përcaktuara në kreun IV, të këtij vendimi.

8. Ofertat duhet të dorëzohen dorazi në adresën e përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese dhe brenda afatit. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar do t'i kthehet e pahapur ofertuesit.

9. Ofertat do të dorëzohen në dy zarfe të vulosura me vulën e kandidatit/ofertuesit pjesëmarrës në konkurrim, ku në njërin duhet të jetë shënuar "Origjinal" dhe te tjetri "Kopje". Mosparaqitja sipas përcaktimit bën që oferta të skualifikohet dhe dokumentacioni nuk do t'i kthehet kandidatit/ofertuesit.

10. Afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data në të cilën është botuar formulari për njoftimin e kontratës.

11. Hapja e ofertave është publike dhe bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke lexuar në prani të kandidatëve/ofertuesve emrin dhe adresën e secilit prej tyre. Pasi hap zarfin, lexon me zë të lartë dokumentet e kualifikimit administrativo-ligjor, teknik dhe financiar. Më pas, hap ofertat teknike dhe ofertat financiare. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u komunikon përfaqësuesve ditën, vendin dhe orën për klasifikimin përfundimtar të kandidatëve/ofertuesve.

12. Bazuar në ofertat e pranuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i procedurës së konkurrimit harton renditjen përfundimtare. Nëse më shumë se një ofertë ka të njëjtën numër pikësh, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të kandidatëve/ofertuesve. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i vlerësimit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia propozon fituesin titullarit të institucionit përgjegjës.

13. Konkurruesit e skualifikuar nga konkurrimi ose jofitues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e nesërme e punës nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për vendimin, pa cenuar të drejtën e ankimit të tyre në Gjykatën Administrative. Ankimi paraqitet te kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesave. Komisioni i shqyrtimit të ankesave merr vendim dhe kthen përgjigje brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj.

14. Njësia e vetëqeverisjes vendore fton kandidatin/ofertuesin e shpallur fitues të fillojë procedurat e negocimit të kontratës menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit, të cilat përfundojnë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i afatit të publikimit.

**III. Procedura në rastin e bashkëfinancimit për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimi**

1. Bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetëqeverisje vendore dhe subjekteve private për bashkëfinancimin e ndërtimit mbi truall privat, mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, realizohet me njërën prej formave:

a) me kërkesën e subjektit privat për leje ndërtimi/zhvillimi mbi truallin në pronësi private;

b) me thirrjen publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore për shprehjen e interesit të subjekteve private për ndërtim.

A. Procedura me kërkesë të subjektit privat për leje ndërtimi/zhvillimi mbi truallin në pronësi private.

2. Procedura me kërkesë zhvillohet në rastet e bashkëfinancimit të investimit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi në troje që janë në pronësi private, mbështetur në kërkesën e subjektit privat për leje zhvillimi dhe ndërtimi, të parashikuara nga legjislacioni për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe rregullorja përkatëse.

3. Struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi, njofton menjëherë strukturën përgjegjëse për strehimin dhe atë përgjegjëse për buxhetin vendor, duke i vënë në dispozicion dokumentacionin tekniko-ekonomik të objektit në mënyrë që të vlerësohen mundësitë e bashkëfinancimit.

4. Kur strukturat përgjegjëse sipas pikës 3, të këtij kreu, vlerësojnë se bashkëfinancimi nga të ardhurat e bashkisë është i mundur, brenda 3 (tri) ditëve pune i paraqesin raportin kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vendimmarrje.

5. Kryetari i njësisë ngre menjëherë një komision negocimi, në përbërje të të cilit janë jo më pak se 3 (tre) specialistë me profil ekonomist, jurist dhe arkitekt ose inxhinier. Komisioni i propozon zhvilluesit mundësinë e bashkëfinancimit. Nëse zhvilluesi bie dakord për bashkëfinancimin, llogaritja e sipërfaqes së ndërtimit që i takon secilit prej bashkëfinancuesve ndahet sipas përqindjes së financimit pasi janë zbritur sipërfaqet që i takojnë pronarit të tokës dhe 3% kontribut për bashkinë.

B. Procedura e përzgjedhjes me thirrje për shprehje interesi nga subjekte private për bashkëfinancim

6. Procedura e përzgjedhjes me ftesë publike për shprehje interesi nga subjektet private për bashkëfinancim zbatohet kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka në dispozicion fonde investimi për banesa sociale, por nuk disponon truall në pronësi të saj për ndërtim dhe synon integrimin e familjeve në nevojë nëpërmjet përzierjes sociale.

7. Shpallja e ftesës publike për shprehje interesi nga subjekte private për bashkëfinancim bëhet nëpërmjet shpalljes në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, si dhe në çdo vend ku mendohet se do të merret dijeni nga palët e interesuara. Shpallja qëndron e publikuar për shtatë ditë rresht në median e shkruar dhe vizive me shikueshmërinë ose tirazhin më të lartë të botimit brenda vendit dhe në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare vendore dhe Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Thirrja përmban shumën e fondeve që njësia e vetëqeverisjes vendore ka në dispozicion për investimin në banesa sociale dhe sipërfaqen minimale që pret përkundrejt kësaj shume. Sipërfaqja minimale përcaktohet si raport i shumës së fondeve që do të vërë në dispozicion bashkia dhe vlerës mesatare të shitblerjes së banesave në njësinë vendore përkatëse.

9. Në rastin kur thirrjes publike i përgjigjen më shumë se një zhvillues/investitor, njësia e vetëqeverisjes vendore vendos për të bashkëfinancuar subjektin që ofron kombinimin më të mirë të parametrave, si më poshtë vijon:

a) Sipërfaqen më të madhe të ndërtimit;

b) Vendndodhjen më të përshtatshme.

**IV. Kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin**

1. Kontrata e shkëmbimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, dhe kreut II, të këtij vendimi, dhe ajo e bashkëfinancimit për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, dhe kreut III, të këtij vendimi, lidhet ndërmjet kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose personit të autorizuar

prej tij dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit privat zhvillues/investitor dhe përmban:

a) objektin e punimeve që do të kryhen për ndërtimin dhe zhvillimin e truallit për strehim;

b) afatin e kryerjes së punimeve;

c) të drejtat dhe detyrimet e palëve;

ç) përcaktimin e pronësisë mbi truallin në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportet e pronësisë mbi ndërtesën dhe truallin pas ndërtimit dhe zhvillimit;

d) të dhënat që identifikojnë vendndodhjen e njësive në objekt (si hyrja, kati, orientimi) që do të përfitohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

dh) rastet e mosmarrëveshjeve dhe drejtimi tek organet kompetente mbi mospërmbushjen e detyrimeve;

e) të drejtat e palëve për të monitoruar punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga zhvilluesi;

ë) çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të ndërtuesit, sipas kontratës;

f) përcaktimin e risqeve që lidhen me ndërtimin, të cilat rëndojnë mbi zhvilluesin privat nga zbatimi i kontratës mbështetur në parashikimet e Kodit Civil për kontratën e sipërmarrjes. Përcaktimi i rrezikut mbështetet në parimin që rreziku rëndon mbi palën që është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij, duke u kujdesur për balancimin e fitimeve dhe humbjeve në mënyrë të drejtë mes palëve kontraktore;

g) mosmarrëveshjet që do të ndeshen si pasojë e moszbatimit të kontratës/ave ndërmjet institucionit publik dhe subjektit privat do të zgjidhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Është pjesë përbërëse e kontratës edhe planvendosja e objektit, e hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe i konfirmuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin e së cilës është territori që do të shpallet zona, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë, si dhe planimetria e detajuar e objekteve në qoftë se ka. Kostot për hartimin e planit të detajuar përballohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

3. Kontrata e bashkëfinancimit për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, dhe kreu III, i këtij vendimi, në rastin kur paraqitet kërkesa për leje zhvillimi ose ndërtimi, në truallin, pronë e subjekteve private, përveç elementeve standarde të kontratës, parashikuar në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi përmban edhe:

a) vlerën e kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë), e cila përfaqëson shumën e bashkëfinancimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore si dhe metodën e pagesës;

b) detyrimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për moskrijimin e vonesave në kryerjen e financimit;

c) detyrimin e subjektit privat për t'i dorëzuar njësisë së vetëqeverisjes vendore sipërfaqen e ndërtimit, të konvertuar në njësi banimi sipas normave në fuqi, dhe marrëveshjes së dakordësuar.

4. Kontrata shkëmbimit për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, nëpërmjet ndërtimit nga subjekti privat në truallin në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore në këmbim të përfitimit nga njësia vendore të një përqindjeje të caktuar sipërfaqe ndërtimi, të përshtatur në apartamente, sipas normave të strehimit, si kundërvlerë e vlerës së truallit të pajisur me infrastrukturë, mbështetur në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 22/2018, dhe kreun II, të këtij vendimi, përveç elementeve standarde të kontratës, të parashikuar në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi, përmban edhe:

a) mënyrën ose skemën e bashkëpunimit dhe të investimit;

b) përqindjet ose raportet e shkëmbimit të vlerës së truallit me sipërfaqe ndërtimi të konvertuar në apartamente sociale, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

c) detyrimin e subjektit privat për të dorëzuar sipërfaqen e ndërtimit, të konvertuar në njësi banimi sipas normave në fuqi dhe, sipas rastit, sipërfaqet e mjediseve të shërbimit, në varësi të kushteve të rëna dakord në marrëveshje.

5. Kontratat, sipas pikës 1, të kreut IV, të këtij vendimi, lidhur mes palëve me akt noterial, regjistrohen në regjistrin kadastral, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën". Me mbarimin dhe materializimin e objektit të ndërtuar dhe me pajisjen me certifikatën e përdorimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, pronësia kalon në mënyrë të ndërsjellë në favor të njësisë së

vetëqeverisjes vendore dhe në favor të subjektit privat si mbi truallin, ashtu edhe mbi apartamentet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

6. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 443, datë 22.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARAPAKETIMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr. 126/2020, "Për metrologjinë",[1] me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për parapaketimet, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1352, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për parapaketimet".
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**RREGULLORE**
PËR PARAPAKETIMET

KREU I
KRITERET, PARIMET KRYESORE DHE MASAT E PËRGJITHSHME PËR PARAPAKETIMET

Neni 1
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton kërkesat metrologjike ligjore ndaj përmbajtjes së sasisë neto, rregullat mbi sasitë nominale për produktet që vendosen në parapaketime, mbishkrimet e shenjat e vendosura në parapaketime dhe metodat referuese për kontrollin e sasisë neto.

Neni 2
**Përkufizime**

Për qëllim të kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Parapaketim" është kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual me të cilin është parapaketuar. Një produkt është i parapaketuar kur ai vendoset në një paketim, të çfarëdo natyre qoftë, pa qenë blerësi prezent dhe sasia e produktit që përmbahet në paketim ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa u hapur paketimi ose pa iu nënshtruar një modifikimi të perceptueshëm.
2. "Sasia nominale" (pesha nominale ose volumi nominal) e përmbajtjes së një parapaketimi është pesha ose volumi i deklaruar në parapaketim, që do të thotë sasia e produktit që parapaketimi mendohet se përmban.
3. "Përmbajtja aktuale" (përmbajtja e vërtetë neto) është sasia (pesha ose volumi) e produktit që përmban në fakt parapaketimi.
4. "Gabimi negativ i një parapaketimi" është sasia me të cilën përmbajtja aktuale e parapaketimit është më pak se sasia nominale.
5. "Metoda referuese" është një metodë e kontrollit të parapaketimeve e përdorur nga strukturat e kontrollit me qëllim sqarimin e korrektësisë së procesit të paketimit të produktit.
6. "Parti e parapaketimeve" - këtej e në vijim "parti" – është një numër i caktuar i parapaketimeve identike që kanë të njëjtën sasi

---
[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me:
Direktivën e datës 20 janar 1976 për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me parapaketimet (76/211/EEC) e amenduar nga direktivat 78/891/EEC e datës 28 shtator 1978 dhe 2007/45/EC e datës 5 shtator 2007.
Direktivën e datës 5 shtator 2007 për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sasitë nominale për produktet e parapaketuara (2007/45/EC).

nominale, të paketuar në të njëjtat kushte dhe në të njëjtin interval kohe.

7. "Mostër" është një numër i caktuar parapaketimesh të marra në një mënyrë të çfarëdoshme (të rastësishme) nga një parti (dhe zgjidhet në mënyrë të tillë që të jetë sa më përfaqësuese e saj) dhe përdoret si bazë për vlerësimin e partisë.

Neni 3
**Kriteret dhe parimet e vendosjes në treg të parapaketimeve**

1. Produktet e listuara në pikën 2 të aneksit nr. 1 duhet të vendosen në treg dhe të ofrohen për shitje si parapaketime vetëm nëse sigurojnë që janë paketuar sipas sasive nominale të përshkruara në pikën 1, të këtij aneksi.

2. Vendosja në treg e parapaketimeve që plotësojnë kërkesat dhe testet e përcaktuara në këtë rregullore, për arsyet që kanë të bëjnë me shenjat që kërkohen të vendosen në parapaketime, sasitë nominale të paketimit, përcaktimin e volumit apo peshës së tyre ose metodave me të cilat ato janë matur ose kontrolluar nuk mund të refuzohen, të ndalohen apo të kufizohen.

Neni 4
**Masat e përgjithshme për parapaketimet**

1. Paketuesi ose importuesi është përgjegjës për të siguruar që parapaketimet e vendosura në treg i përmbushin kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Sasia e produktit që përmban një parapaketim (ose sasia e paketimit), i njohur si "përmbajtja aktuale", duhet të matet ose kontrollohet sipas masës ose volumit nën përgjegjësinë e paketuesit dhe/ose importuesit.

3. Instrumentet matëse që do të përdoren për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve duhet të jenë të përshtatshme dhe të verifikuara nga organet përkatëse të DPM-së ose personat juridike të autorizuar për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara dhe që mbajnë shenja të vlefshme që vërtetojnë këtë verifikim. Kontrolli mund të kryhet nëpërmjet marrjes së mostrave.

4. Kur përmbajtja aktuale nuk matet, kontrolli i kryer nga paketuesi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që sasia e përmbajtjes të sigurohet në mënyrë efektive.

5. Ky kusht plotësohet nëse paketuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të prodhimit në përputhje me procedurat e miratuara nga DPM-ja. Paketuesi mban në dispozicion të ISHMT-së dhe DPM-së dokumentet që përmbajnë rezultatet e kontrolleve të tilla, për të vërtetuar se këto kontrolle, së bashku me ndonjë korrigjim dhe përshtatje që ata kanë konsideruar të nevojshme, janë kryer siç duhet dhe me saktësi.

6. Importuesi në vend të matjeve dhe kontrolleve siguron prova, të cilat përfshijnë deklaratën e paketuesit (prodhuesit), si edhe dokumente që përmbajnë rezultatet e kontrollit/ testimit që ai zotëron si dhe të gjitha garancitë e nevojshme që e mundësojnë atë për të marrë përgjegjësinë.

7. Në rastin e produkteve në sasi të shprehura në njësi të volumit, një nga metodat e shumta për të përmbushur kërkesat e matjes dhe kontrollit, kur përgatiten paketime në një enë matëse të llojit të përcaktuar në rregulloren e "shisheve enëmatëse" duhet të përdoret mbushja sipas kushteve të përcaktuara në atë rregullore dhe sipas kësaj rregulloreje.

KREU II
PARAPAKETIMET QË KONTROLLOHEN LIGJËRISHT

Neni 5
**Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për parapaketimet që përmbajnë produkte të destinuara për shitje në sasi konstante nominale të njësive të cilat janë:

1.1 të barabarta me vlerat e paracaktuara nga paketuesi;

1.2 të shprehura në njësi të masës ose volumit,

1.3 jo më pak se 5 g ose 5 mL dhe jo më shumë se 10 kg ose 10 litra*.

* Për parapaketimet mbi 10 kg ose 10 litra nuk vendoset shenjë konformiteti dhe do të zbatohen në mënyrë të detyrueshme kërkesat e nenit 7, pikat 1 dhe 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje.

2. Kjo rregullore nuk cenon dispozitat specifike të legjislacionit në fuqi të zbatuara për produktet ushqimore.

Neni 6

**Përjashtime nga fusha e zbatimit**

Kjo rregullore nuk zbatohet për parapaketimet në sasi nominale të njëjtë të lëngjeve të listuara në aneksin nr. 1, që kanë për qëllim shitjen në *duty-free shops* (dyqanet pa taksa doganore).

KREU III
KËRKESAT METROLOGJIKE PËR SASINË NETO TË PARAPAKETIMEVE

Neni 7

**Kërkesat thelbësore**

1. Kërkesat e këtij kreu zbatohen për përmbajtjet aktuale të produktit (peshë ose volum) të quajtura "sasi neto".

2. Parapaketimet e mbuluara nga kjo rregullore në sasi nominale të njëjtë të prodhohen në mënyrë të tillë që e gjithë partia të plotësojë njëkohësisht kërkesat që vijojnë:

2.1 përmbajtja aktuale (e partisë së parapaketimeve) nuk do të jetë më e vogël, mesatarisht, sesa ajo nominale;

2.2 përqindja e parapaketimeve që kanë një gabim negativ më të madh se gabimi negativ i lejuar i përcaktuar në tabelën e nenit 11, duhet të jetë mjaft i vogël për grupet (seritë) e parapaketimeve për të përmbushur kërkesat e testeve të specifikuara tek aneksi 2;

2.3 asnjë parapaketim që ka një gabim negativ më të madh se dyfishi i gabimit negativ të lejuar të dhënë në tabelën e nenit 11 nuk mund të mbajë shenjën "e" të përcaktuar tek aneksi 3.

Neni 8

**Kërkesat për sasitë nominale**

1. Parapaketimet ligjërisht të kontrolluara duhet të tregojnë peshën ose volumin e produktit, në përputhje me aneksin 2, të njohur si "pesha nominale" ose "volumi nominal", të cilat është e kërkuar që t'i përmbajnë.

2. Parapaketimet që përmbajnë produkte të lëngëta do të shënohen me volumin e tyre nominal dhe parapaketimet që përmbajnë produkte të tjera do të shënohen me masën nominale të tyre.

Neni 9

**Kërkesat për kontrollin e sasive të produkteve të shprehura në njësi të volumit**

1. Në të gjitha veprimet për kontrollin e sasive të produkteve të shprehura në njësi të volumit, vlera e përdorur për përmbajtjet aktuale do të matet ose korrektohet në një temperaturë 20ºC, pavarësisht se në çfarë temperature është kryer paketimi ose kontrolli.

2. Ky rregull nuk do të zbatohet për produktet e ngrira ose gjysmë të ngrira, sasia e të cilave shprehet në njësi të volumit.

Neni 10

**Parapaketime me shenjë konformiteti**

Parapaketimet mund të shënohen me shenjë konformiteti "e" të specifikuar në pikën 1 të nenit 18, vetëm nëse ato plotësojnë të gjitha kërkesat e kësaj rregullore dhe sipas rregullave dhe procedurave që rrjedhin nga neni 38 i ligjit për metrologjinë.

Neni 11

**Gabimet negative të lejuara**

1. Gabimet negative të lejuara në përmbajtjet e parapaketimeve në sasi nominale të njëjtë do të jenë sipas tabelës[2].

| **Sasia nominale (Qn, Vn) në gramë ose mililitra (g, mL)** | **Gabimi negativ i lejuar** | |
|---|---|---|
| | si % e Qn ose Vn | g ose mL |
| 5 deri 50 | 9 | - |
| nga 50 deri 100 | - | 4.5 |
| nga 100 deri 200 | 4.5 | - |
| nga 200 deri 300 | - | 9 |
| nga 300 deri 500 | 3 | - |
| nga 500 deri 1000 | - | 15 |
| nga 1000 deri 10000 | 1.5 | - |
| nga 10000 deri 15000 | - | 150 |
| mbi 15000 | 1 | - |

2. Vlerat e gabimeve negative të lejuara, të dhëna në tabelë në përqindje, të llogaritura në njësi të volumit ose të peshës, do të rrumbullakosen te vlera më e afërt e një të dhjetës së gramit ose mililitrit.

[2] Referuar rekomandimit ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore OIML R 87:2016.

KREU IV
DIAPAZONET E DETYRUESHME PËR SASINË NOMINALE TË DISA PARAPAKETIMEVE

Neni 12
**Diapazonet e sasive nominale të përmbajtjeve të parapaketimeve**

1. Diapazonet e sasive nominale të përmbajtjeve të parapaketimeve për disa produkte specifike të shitura me volum duhet të jenë sipas pikës 1, të aneksit 1.
2. Përkufizimet e produkteve, të referuara në pikën 1, që vendosen në parapaketime së bashku me kodet sipas nomenklaturës së mallrave jepen në pikën 2, të aneksit 1.

Neni 13
**Paketime të shumëfishta (multipakot)**

1. Kur dy ose më shumë parapaketime individuale përbëjnë një paketim të shumëfishtë (multipako), sasitë nominale të listuara në pikën 1 të aneksit 1 do të zbatohen për çdo parapaketim individual.
2. Kur një parapaketim përbëhet nga dy ose më shumë paketime individuale të cilat nuk kanë për qëllim të shiten individualisht, sasitë nominale të listuara në pikën 1 të aneksit 1 do zbatohen në parapaketim.

Neni 14
**Shpërndarësit e aerosolëve**

1. Shpërndarësit e aerosolëve duhet të tregojnë kapacitetin nominal total të kontejnerit. Ky tregim do të bëhet në mënyrë të tillë që të mos krijojë konfuzion me volumin nominal të përmbajtjes.
2. Produktet që shiten në shpërndarësit e aerosolëve nuk nevojitet të shënohen me peshën nominale të përmbajtjeve të tyre.

KREU V
METODAT REFERUESE PËR KONTROLLIN E SASISË NETO TË PARAPAKETIMEVE

Neni 15
**Kontrolli i sasisë neto të parapaketimeve**

1. Kontrolli për të siguruar që parapaketimet përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje do të kryhen nga:
1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë miratimit të sistemit të kontrollit sasior të paketuesve dhe monitorimit periodik të tij, në mbështetje të nenit 38 të ligjit për metrologjinë duke marrë mostra në ambientet e paketuesit (në linjën e paketimit).
1.2 Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë sipas shkronjës "b", të neneve 9, 35 dhe 37 të ligjit për metrologjinë, duke marrë mostra në ambientet e paketuesit, importuesit ose agjentit të tij të vendosur në Shqipëri.
2. Kontrolli statistikor me marrje mostre do të bëhet në përputhje me metodat e pranuara të inspektimit të pranimit të cilësisë. Efektshmëria duhet të jetë e krahasueshme me metodën referencë të specifikuar në aneksin 2.
3. Kjo rregullore nuk do të përjashtojë asnjë kontroll (verifikim) që mund të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për aq kohë ku qëllimi është verifikimi i parapaketimeve për të plotësuar kërkesat e kësaj rregulloreje.
4. Inspektorati kryen inspektime për të gjithë paketuesit, importuesit dhe rrjetin e tregtimit pa kufizime, referuar vlerësimit të riskut, në zbatim të kësaj rregulloreje.

Neni 16
**Kriteret e krahasimit dhe metodat referuese të kontrollit të sasisë neto të parapaketimeve**

1. Për kriterin e përmbajtjes minimale, një plan i mostrimit i përdorur nga strukturat përkatëse do të konsiderohet i krahasueshëm me atë të rekomanduar në aneksin 2 nëse abshisa e pikës 0.10 të koordinatave të kurbës karakteristike të veprimit të planit të parë (probabiliteti i pranimit të partisë = 0.10) devijon me më pak se 15% nga abshisa e pikës përkatëse të kurbës karakteristike të

funksionimit të planit të mostrimit të rekomanduar në aneksin 2.

2. Për kriterin e mesatares së llogaritur me metodën e devijimit standard, një plan i mostrimit i përdorur nga strukturat përkatëse do të konsiderohet i krahasueshëm me atë të rekomanduar në aneksin 2, nëse, duke marrë parasysh kthesat karakteristike të funksionimit të dy planeve që kanë aksin e abshisës (Qn-m)/s, abshisa e pikës 0.10 të rendit të kurbës së planit të parë (probabiliteti i pranimit të partisë = 0.10) devijon nga më pak se 0.05 nga abshisa e pikës përkatëse të kurbës së planit të mostrimit të rekomanduar në aneksin 2.

KREU VI
MBISHKRIMET DHE SHENJAT E VENDOSURA NË PARAPAKETIME

Neni 17
**Rregullat e mbishkrimeve në parapaketime**

1. Të gjitha parapaketimet e bëra në përputhje me këtë rregullore duhet të mbajnë mbi paketim mbishkrimet e mëposhtme të vendosura në mënyrë të tillë që të jenë të paheqshme, lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në parapaketim në kushte normale të paraqitjes.

2. Mbishkrimet e sasisë nominale (masa nominale ose volumi nominal) në parapaketime do të deklarohet në kilogram, gramë, litër, centilitër ose mililitër dhe do të shënohet në shifra në madhësi të paktën:

- 6 mm lartësi nëse sasia nominale kalon 1000 g ose 100 cL,
- 4 mm e lartë nëse është nga 1000 g ose 100 cL përfshirë deri në 200 g ose 20 cL,
- 3 mm të larta nëse është nga 200 g ose 20 cL deri në 50 gramë ose 5 cL,
- 2 mm e lartë nëse nuk është më shumë se 50 g ose 5 cL, pasuar nga simboli për njësinë e matjes së përdorur.

3. Një markë ose mbishkrim që mundëson autoritetet shqiptare të identifikojnë paketuesin ose personin që rregullon paketimin ose importuesin.

Neni 18
**Rregullat e shenjës së konformitetit**

1. Shenja e konformitetit do të jetë të paktën 3 mm e lartë dhe e vendosur në të njëjtën fushëpamje si dhe treguesi i masës nominale ose volumit nominal, e cila përbën një garanci nga paketuesi ose importuesi që parapaketimi i plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Kjo shenjë do të ketë formën, përmasat dhe paraqitjen grafike sipas aneksit 3.

ANEKSI NR. 1
DIAPAZONET E DETYRUESHME PËR SASINË NOMINALE TË PËRMBAJTJES SË DISA PARAPAKETIMEVE

1. Produkte të shitura sipas volumit (sasia në mL)

| **Lëngjet** | **Volumi nominal i përmbajtjeve të lejuara në mL** |
|---|---|
| Verë e pagazuar | Në intervalin nga 100 mL deri në 1500 mL, vetëm 8 sasi nominale që vijojnë:<br>mL: 100 - 187 - 250 - 375 - 500 - 750 - 1000 - 1500 |
| Verë e verdhë (e bardhë) | Në intervalin nga 100 mL deri 1500 mL, vetëm sasia nominale që vijon:<br>mL: 620 |
| Verë e gazuar | Në intervalin nga 125 mL deri 1500 mL, vetëm 5 sasitë nominale që vijojnë:<br>mL: 125 - 200 -375 - 750 - 1500 |
| Verë liker | Në intervalin nga 100 mL deri në 1500 mL, vetëm 7 sasi nominale si vijon:<br>mL: 100 - 200 - 375 - 500 - 750 - 1000 - 1500 |
| Verë e aromatizuar | Në intervalin nga 100 mL deri në 1500 mL, vetëm 7 sasi nominale si vijon:<br>mL: 100 - 200 - 375 - 500 - 750 - 1000 - 1500 |
| Pije alkoolike (pije të forta) | Në intervalin 100mL deri 2000 mL, vetëm 9 sasitë nominale si vijon<br>mL:<br>100 - 200 - 350 - 500 - 700 - 1000 - 1500 - 1750 - 2000 |

2. Përkufizimet e produktit

| | |
|---|---|
| Verë e pagazuar | Verë prej rrushi të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi:<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2204). |
| Verë e verdhë (e bardhë) | Verë prej rrushi të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi; me emërtimin e origjinës: "Côtes du Jura", "Arbois", "L'Etoile" dhe 'Château-Chalon":<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2204). |
| Verë e gazuar | Verë prej rrushi të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi; verë spumante:<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2204 10). |
| Verë liker | Verëra të tjera, musht rrushi me fermentim të penguar apo kufizuar nga shtesa e alkoolit:<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2204 21 – 2204 29). |
| Verë e aromatizuar | Vermuth dhe verëra të tjera prej rrushi të freskët, aromatizuar me bimë apo me substanca aromatizuese:<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2205). |
| Pije alkoolike (pije të forta) | Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80% vol; pije alkoolike, likere dhe alkoole të tjera:<br>Kodi sipas nomeklaturës së mallrave dhe tarifa doganore (kodi NC 2208). |

ANEKSI NR. 2

METODA REFERUESE PËR KONTROLLIN STATISTIKOR ME MOSTRA TË PARTIVE TË PARAPAKETIMEVE NË SASI NOMINALE TË NJËJTË

Ky aneks përcakton procedurat e metodës së referimit për kontrollin statistikor të partive të parapaketimeve për të përmbushur kërkesat.

**1. Kërkesat për matjen e përmbajtjes aktuale (neto) të parapaketimeve**

Përmbajtja aktuale e parapaketimeve mund të matet direkt duke përdorur instrumentet matëse të masës ose volumit ose, në rastin e lëngjeve, në mënyrë indirekte, duke matur masën e produktit të paketuar dhe densitetin e tij.

Pavarësisht metodës së përdorur, gabimi në matjen e përmbajtjes aktuale të parapaketimit nuk duhet të tejkalojë një të pestën e gabimit të lejueshëm negativ për sasinë nominale në parapaketim.

Procedura për matjen e përmbajtjes aktuale të një parapaketimi do të jetë pjesë e procedurave teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe inspektoratit që mbulon fushën e metrologjisë.

**2. Kërkesat për kontrollin e partisë së parapaketimeve**

Kontrolli i parapaketimeve duhet të kryhet me marrjen e mostrave dhe duhet të jetë në dy pjesë:

a) një kontroll që mbulon përmbajtjet aktuale të çdo parapaketimi në një mostër;

b) një kontroll tjetër për mesataren e përmbajtjeve aktuale të secilit parapaketim në një mostër.

Një parti parapaketimesh do të konsiderohet e pranueshme nëse rezultatet e të dyja këtyre kontrolleve plotësojnë kriteret e pranimit.

Për secilën nga këto kontrolle, ka dy plane të marrjes së mostrave:

a) njëri plan marrje mostre për testim pa shkatërrim, testim që nuk përfshin hapjen e paketimit (jo shkatërrimin e ambalazhit);

b) tjetri plan marrje mostre për testimin me shkatërrim, testim që përfshin hapjen e paketimit (shkatërrimin e ambalazhit).

Për arsye ekonomike dhe praktike, testi me shkatërrim ambalazhi do të kufizohet në minimumin absolut thelbësor; është më pak efikas se testi joshkatërrues.

Testimi me shkatërrim duhet të përdoret vetëm atëherë kur testimi joshkatërrues është i pamundur. Kjo nuk do të aplikohet te partitë me më pak se 100 njësi.

**2.1 Partitë e parapaketimeve**

2.1.1 Partia e kontrolluar do të përmbajë parapaketime me sasi nominale të njëjtë, të të njëjtit tip dhe të njëjtës linjë prodhimi, të paketuar në të njëjtin vend. Madhësia e partisë që do të kontrollohet, do të përcaktohet si vijon.

2.1.2 Kur parapaketimet kontrollohen në fund të linjës së paketimit, numri i secilës parti do të jetë i barabartë me maksimumin e prodhimit orar të paketimit pa ndonjë rregullim ose veprim korrigjues tjetër, me përjashtim të atyre normale. Në të gjitha rastet e tjera madhësia e partisë do të kufizohet te 10000 njësi.

2.1.3. Për partitë më të vogla se 100 parapaketime, kontrolli pa shkatërrim do të jetë 100%.

2.1.4. Para kryerjes së testeve të përmendura në pikat 2.2 dhe 2.3, një numër i konsiderueshëm i parapaketimeve duhet të nxirret në mënyrë të rastësishme nga partia, në mënyrë që të mund të kryhet kontrolli që kërkon mostër më të madhe.

Për kontrollin tjetër, mostra e nevojshme duhet të nxirret në mënyrë të rastësishme nga mostra e parë dhe duhet të shënjohet. Ky veprim shënjimi duhet të përfundojë para fillimit të veprimeve matëse.

**2.2 Kontrolli i përmbajtjes aktuale të një parapaketimi**

Përmbajtja minimale e pranueshme do të llogaritet duke zbritur gabimin negativ të lejuar për përmbajtjen në fjalë nga sasia nominale e paketimit.

Parapaketimet në parti, përmbajtja aktuale e të cilave është më e vogël se përmbajtja minimale e lejuar do të konsiderohen difektoze.

**2.2.1 Testimet pa shkatërrim**

Testimi joshkatërrues duhet të kryhet në përputhje me planin e mostrimit të dyfishtë, siç paraqitet në tabelën nr. 1 të mëposhtme:

Numri i parë i parapaketimeve të kontrolluara është i njëjtë me numrin e njësive në mostrën e parë, siç tregohet në planin dyfish të marrjes së mostrave:

a) nëse numri i njësive difektoze të gjetura në mostrën e parë është më i vogël ose i barabartë me kriterin e parë të pranimit, partia konsiderohet e pranueshme për këtë kontroll;

b) nëse numri i njësive difektoze të gjetura në mostrën e parë është i barabartë ose më i madh se kriteri i parë i refuzimit, partia refuzohet;

c) nëse numri i njësive difektoze të gjetura në mostrën e parë bie ndërmjet kriterit të parë të pranimit dhe kriterit të parë të refuzimit, një nën - mostër e dytë kontrollohet, numri i njësive të secilës është treguar në plan (për marrjen e mostrave). Njësite difektoze të gjetura në mostrën e parë dhe mostrën e dytë mblidhen së bashku dhe:

i. nëse numri total i njësive difektoze është më i vogël se, ose i barabartë me kriterin e dytë të pranimit, partia do të konsiderohet e pranueshme për këtë kontroll;

ii. nëse numri total i njësive difektoze është më i madh se, ose i barabartë me kriterin e dytë të refuzimit, partia do të refuzohet.

Kriteret për pranimin ose refuzimin e partive të parapaketimeve në sasi nominale të njëjtë të kontrolluara me testim pa shkatërrim.

Tabela nr. 1

| Numri në parti | Mostrat | | | Numri i njësive difektoze | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Rangu | Numri | Numri total | Kriteri i pranimit | Kriteri i refuzimit |
| 100 deri 500 | 1-rë | 30 | 30 | 1 | 3 |
| | 2-të | 30 | 60 | 4 | 5 |
| 501 deri 3200 | 1-rë | 50 | 50 | 2 | 5 |
| | 2-të | 50 | 100 | 6 | 7 |
| 3201 e sipër | 1-rë | 80 | 80 | 3 | 7 |
| | 2-të | 80 | 160 | 8 | 9 |

**2.2.2 Testimi shkatërrues**

Testimi shkatërrues do të kryhet në përputhje me planin e vetëm të marrjes se mostrave më poshtë dhe do të përdoret vetëm për partitë prej 100 ose më shumë parapaketime.

Numri i parapaketimeve të kontrolluara do të jetë i barabartë me 20.

1. nëse numri i njësive difektoze të gjetura është me i vogël se ose i barabartë me kriterin e pranimit, partia e prapaketimeve do të konsiderohet e pranueshme;

2. nëse numri i njësive difektoze të gjetura është i barabarte me ose më i madh se kriteri i refuzimit, partia e parapaketimeve refuzohet.

**Kriteret e pranimit dhe refuzimit të partisë së parapaketimeve në sasi nominale të njëjtë të kontrolluara me testim shkatërrues.**

Tabela nr. 2

| Numri në parti | Numri në mostër | Numri i parapaketimeve të kontrolluara | Numri i njësive difektoze | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Kriteri i pranimit | Kriteri i refuzimit |
| Sidoqoftë numri (≥ 100) | 20 | 20 | 1 | 2 |

2.3 Kontrolli i përmbajtjes aktuale mesatare të parapaketimeve individuale që përbëjnë një parti.

2.3.1 Një parti parapaketimesh do të konsiderohet e pranueshme për qëllim të këtij kontrolli nëse vlera mesatare $\bar{x} = \frac{\sum x_i}{n}$ e përmbajtjeve aktuale xie n- parapaketimeve në një mostër është më e madhe se vlera e kriterit të pranimit: $Q_n - \frac{s}{\sqrt{n}} \cdot t_{(1-\alpha)}$

Në këtë formulë:
Qn = sasia nominale e deklaruar e parapaketimit
n = numri i parapaketimeve në mostër për këtë kontroll
s = devijimi standard i vlerësuar i përmbajtjeve aktuale të partisë
t(1 – α)= 0.995 niveli i besimit i një shpërndarje të studentit me ν = n – 1 shkallë lirie

2.3.2 Nëse $x_i$ është vlera e matur për përmbajtjen aktuale e i - njësi në një mostër që përmban n njësi, atëherë:

2.3.2.1 Mesatarja e vlerave të matura për mostrën merret nga llogaritja që vijon:

$$\bar{x} = \frac{\sum_{i=1}^{i=n} x_i}{n}$$

2.3.2.2 Vlera e vlerësuar e devijimit standard s merret nga formula e mëposhtme:

- shuma e katrorit të vlerave të matura: $\sum_{i=1}^{i=n} (x_i)^2$
- katrori i shumës së vlerave të matura: $(\sum_{i=1}^{i=n} x_i)^2$, pastaj $\frac{1}{n}(\sum_{i=1}^{i=n} x_i)^2$
- shuma e korrektuar: $SC = \sum_{i=1}^{i=n} (x_i)^2 - \frac{1}{n}(\sum_{i=1}^{i=n} x_i)^2$
- varianca e llogaritur: $v = \frac{SC}{n-1}$
- vlera e llogaritur e devijimit standard është $s = \sqrt{v}$

**2.3.3 Kriteri i pranimit ose refuzimit të partisë së parapaketimeve për kontrollin e mesatares**

**2.3.3.1 Kriteri për testimin joshkatërrues**

Tabela nr. 3

| Numri në parti | Numri i mostrës | Kriteri | |
|---|---|---|---|
| | | i pranimit | i refuzimit |
| 100 deri 500 (e përfshirë) | 30 | $\bar{x}$ ≥Qn-0.503 s | $\bar{x}$ <Qn-0.503 s |
| > 500 | 50 | $\bar{x}$ ≥Qn-0.379 s | $\bar{x}$ <Qn-0.379 s |

**2.3.3.2 Kriteri për testimin shkatërrues**

Tabela nr. 4

| Numri në parti | Numri në mostër | Kriteri | |
|---|---|---|---|
| | | i pranimit | i refuzimit |
| Sidoqoftë numri (≥ 100) | 20 | $\overline{X} \geq Qn-0.640\ s$ | $\overline{X} < Qn-0.640\ s$ |

ANEKSI NR. 3
SHENJA EVROPIANE "E" E KONFORMITETIT TË PARAPAKETIMEVE



Shenja evropiane "e": paraqitja grafike e formës dhe përmasa.

**VENDIM**
**Nr. 446, datë 22.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR PËRMBYTJET DHE VËRSHIMET E UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për përmbytjet dhe vërshimet e ujërave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**MARRËVESHJE GRANTI**
MBI PËRMBYTJET DHE VËRSHIMET E UJËRAVE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim të referuara individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët") kanë rënë dakord për nenet vijuese:

Neni 1

Pala turke do të mundësojë dhurimin e pajisjeve të përfshira në aneksin 1, për të mbështetur Palën shqiptare në luftimin e përmbytjeve dhe vërshimeve të ujërave.

Neni 2

Granti i lëshuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, realizohet nga Pala turke si një gjest miqësie dhe vullneti të mirë, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve të Palës shqiptare në luftën kundër përmbytjeve dhe vërshimeve.

Neni 3

Pajisjet që do të dhurohen, do t'i paraqiten Palës shqiptare brenda kuadrit të procedurave dhe parimeve të vendosura bashkërisht nga Palët.

Shpenzimet në lidhje me transferimin e pajisjeve të dhuruara për në Portin e Izmirit do të mbulohen nga Pala turke, dhe shpenzimet nga Porti i Izmirit për në Portin e Durrësit (duke përfshirë ngarkesën, ngarkimin dhe tarifat e tjera doganore) do të mbulohen nga Pala shqiptare.

Pala shqiptare do të garantojë lehtësimin e nevojshëm doganor dhe procedurat e tjera ligjore në lidhje me pajisjet që do të ofrohen, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Neni 4

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi dhe interpretimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit dhe bisedimit nëpërmjet Palëve.

Neni 5

Pajisjet që do të ofrohen do t'i përkasin Palët shqiptare, pas dorëzimit dhe do të përdoren nga Pala shqiptare në përpjekjet për të luftuar përmbytjet dhe vërshimet.

Neni 6

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të dokumentit përkatës.

Bërë në Tiranë, më 24.2.2021, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Milva Ekonomi**
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË
**Dr. Bekir Pakdemirli**
Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

ANEKS 1
LISTA E PAJISJEVE

| **Numri i makinerive pajisjeve që do të dhurohen** | **Firma Modeli** | **Lloji** | **Viti i prodhimit** |
|---|---|---|---|
| 1 | Fiat Kobelco FD 30 C | Traktor zvarritës | 2004 |
| 1 | Agledozer Blade | Për Fiat Kobelco FD 30 C | 2004 |
| 1 | Fiat Kobelco FL 175 | Ngarkues i gjurmuar | 2004 |
| 1 | Fiat Kobelco W 130 | Ngarkues me rrota | 2004 |
| 2 | Hitachi EX 220 LC-5 | Ekskavator me zinxhirë (me gropë-prapa) | 2002 |
| 4 | ABS | Pompë zhytëse portabël | 2000 |

**VENDIM**
**Nr. 447, datë 22.7.2021**

**PËR KRITERET E DHËNIES SË BURSAVE PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE, PËR TË STUDIUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NGA AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PËR VITIN AKADEMIK 2021–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "ë", të nenit 5, ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e 9 (nëntë) bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2021–2022.

2. Bursa e studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfshin mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për vitin akademik 2021–2022 të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;

b) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit arbëresh në Itali;

c) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;

ç) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgari;

d) 1 (një) bursë studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Turqia.

4. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, bëjnë propozimet për kandidatët për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2021–2022. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.

5. Dokumentacioni që do të paraqitet nga aplikantët duhet të jetë i legalizuar në përputhje me legjislacionin që rregullon njohjen dhe përdorimin e dokumenteve zyrtare të lëshuara jashtë vendit.

6. Kriteret bazë për përfitimin e bursës që duhet të plotësojë aplikanti janë, si më poshtë vijon:

a) të ketë mbaruar arsimin e mesëm të lartë me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlershme me të;

b) të mos jetë i diplomuar në një program studimi të të njëjtit cikël studimi që aplikon;

c) të jetë kandidat për student nga shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga vendet për të cilat ofrohen bursa, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

7. Kriteret për përfitimin e bursave, sipas programeve ku do të studiojnë shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Për ndjekjen e procesit dhe vlerësimin përfundimtar të dokumenteve të kandidatëve, të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit, ku do të studiojnë, krijohet Komisioni i Bursave për Diasporën, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për diasporën, ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të propozohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (1 anëtar), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (1 anëtar) dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës (1 anëtar).

8. Agjencia Kombëtare e Diasporës të mbulojë tarifën për ndjekjen e këtij kursi.

9. Financimi i bursave në zbatim të këtij vendimi, për vitin akademik 2021-2022, ka një vlerë prej 71 520 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) eurosh. Ky financim do të përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

ANEKS 1
MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE

| **Nr.** | **Studentët me origjinë shqiptare** | |
|---|---|---|
| | Tarifa e studimit | 40000 lekë/vit = 30 euro/muaj |
| | Akomodimi | 300 euro/muaj |
| | Shpenzimet ushqimore | 270 euro/muaj |
| | Totali mujor i bursës | 600 euro/muaj |
| | Totali vjetor i bursës | 64800 euro |

| **Nr.** | **Asistentët për mësimin e gjuhës shqipe** | |
|---|---|---|
| | Paga mujore | 560 euro/muaj |
| | Paga vjetore 1 asistent | 6720 euro |
| | **TOTALI (vlera vjetore totale për studentët dhe asistentët)** | 71520 euro |

**VENDIM**
**Nr. 448, datë 22.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ndryshuar, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën boton, siguron dhe shpërndan për kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore për vitin shkollor 2021–2022, sipas listës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kategoritë, që përfitojnë falas tekstet shkollore të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

3. Tekstet shkollore të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon dhe pullën me hologram përkatëse.

4. Çmimet e teksteve shkollore për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinën e tyre, në përputhje me listën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare të këtij vendimi, ku përfshihen botimi, ambalazhimi dhe shpërndarja, të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

LISTA 1
TEKSTE SHKOLLORE PËR DIASPORËN
PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022

| **Titulli i librit** | **Sasia** | **Çmimi për copë/lekë** referuar çmimit në kopertinën e librit |
|---|---|---|
| **Të mësojmë gjuhën amtare 1** | 4303 copë | 340 |
| **Të mësojmë gjuhën amtare 2** | 3808 copë | 340 |
| **Të mësojmë gjuhën amtare 3** | 2985 copë | 340 |
| **TOTALI** | **11 096 copë** | |

* TVSH-ja për librin sipas ligjit nr. 96/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar është 6% (gjashtë).

**VENDIM**
**Nr. 449, datë 22.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES DHE TË KATEGORIVE, QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, "TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE" DHE REVISTA LETRARE "LETRA NGA DIASPORA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ndryshuar, të shkronjës "gj", të nenit 21, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikave 10, shkronja "dh", e 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes të teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, botimi dygjuhësh "Tregime të moçme shqiptare" dhe revista letrare "Letra nga diaspora", sipas listës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit e të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

2. Kategoritë, që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

3. Botimi dygjuhësh "Tregime të moçme shqiptare" dhe revista letrare "Letra nga diaspora", të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni.

4. Çmimi i teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve të Diasporës "Tregime të moçme shqiptare" dhe "Letra nga diaspora" vendoset në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, ku përfshihen botimi, ambalazhimi dhe shpërndarja, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2021.

6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

LISTA NR. 1

I. Çmimi në kopertinë prej 1000 (një mijë) lekësh, sipas tirazhit përkatës, për botimin dygjuhësh "Tregime të moçme shqiptare", me autor Mitrush Kutelin, në 5 (pesë) gjuhë:

1. "Tregime të moçme shqiptare" 1 000 copë; (shqip–anglisht)
2. "Tregime të moçme shqiptare" 1 000 copë; (shqip–italisht)
3. "Tregime të moçme shqiptare" 1 000 copë; (shqip–greqisht)
4. "Tregime të moçme shqiptare" 1 000 copë; (shqip–gjermanisht)
5. "Tregime të moçme shqiptare" 1 000 copë. (shqip–frëngjisht)

II. Çmimi në kopertinë prej 1 200 (një mijë e dyqind) lekësh, sipas tirazhit përkatës, për revistën letrare "Letra nga diaspora" në 2 (dy) gjuhë:

1. "Letra nga diaspora" (shqip) 300 copë;
2. "Letra nga diaspora" (anglisht) 300 copë.

**RREGULLORE**
**Nr. 1, datë 19.7.2021**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TREGUT TË SHËNGJINIT PËR TREGTIMIN E PRODUKTEVE PESHKORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës "g", të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miraton rregulloren si më poshtë:

Neni 1
**Objekti**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të Shëngjinit për shitjen me shumicë dhe tregtimin e produkteve peshkore.

Neni 2
**Menaxhimi i tregut**

1. Tregu i Shëngjinit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

2. Në këtë treg ushtrojnë veprimtaritë e tyre dhe organet shtetërore, si Inspektorati i Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, struktura të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe organe të tjera që kanë lidhje me funksionimin normal të këtij tregu.

Neni 3
**Komiteti Këshillimor i Tregut**

1. Për menaxhimin e tregut të Shëngjinit, krijohet Komiteti Këshillimor i tregut të shitjes me shumicë me mandat trevjeçar. Anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të rizgjidhen.

2. Komiteti Këshillimor i Tregut të Shëngjinit drejtohet nga titullari i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ose një përfaqësues i autorizuar, i cili luan rolin e kryetarit.

3. Komiteti Këshillimor ka në përbërje:

a) dy përfaqësues nga Sektori i Monitorimit dhe Infrastrukturës së Peshkimit, përgjegjësi i sektorit dhe përfaqësuesi lokal;
b) një ekonomist;
c) dy anëtarë të organizatës, përfaqësues të pronarëve të anijeve të peshkimit, njëri përfaqësues i peshkimit tregtar industrial dhe tjetri përfaqësues i peshkimit tregtar artizanal, bregdetar;
ç) një përfaqësues i tregtarëve me shumicë;
d) një përfaqësues i tregtarëve me pakicë;
dh) një përfaqësues i industrisë përpunuese;
e) inspektori i peshkimit;
ë) inspektori i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
f) një përfaqësues i kapitenerisë së porteve;
g) një përfaqësues i të punësuarve në tregun e shitjes me shumicë.

4. Komiteti Këshillimor i tregut mblidhet nga kryetari sa herë që e sheh të nevojshme ose me kërkesë të bërë nga një e treta e anëtarëve.

5. Njoftimet e takimit, me rendin e ditës, dërgohen tek anëtarët të paktën shtatë ditë para datës së mbledhjes, pa paragjykuar asnjë kërkesë urgjente për të cilën dërgohet njoftim 24 orë nga çdo mjet i vlefshëm komunikimi.

6. Në mbledhjet e Komitetit Këshillimor mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, ekspertë për çështjet që do të shqyrtohen ose përfaqësues të grupeve të tjera të interesit.

7. Mbledhjet quhen të vlefshme kur në të marrin pjesë 50% + 1 të anëtarëve të tij.

8. Anëtarët e Komitetit të cilët mungojnë për tri mbledhje radhazi, pa arsye, humbasin mandatin.

9. Vendimet merren me shumicë votash dhe në rast barazimi, vota e kryetarit është përcaktuese.

10. Menaxhuesi i tregut (DSHPA) vendos në mënyrë të pavarur mbi propozimet e Komitetit Këshillimor.

Neni 4
**Funksionet dhe detyrat e Komitetit Këshillimor**

1. Komiteti Këshillimor kryen detyrat e mëposhtme:

a) propozon ndryshime dhe përmirësime për pajisjet dhe shërbimet e tregut, në mënyrë që të sigurohet produktiviteti maksimal dhe përmirësimi i efikasitetit funksional përfshirë edhe sigurinë ushqimore;

b) shpreh mendimin e tij, për:

i. oraret e funksionimit të tregut të shitjes me shumicë;

ii. kriteret për ndarjen e vendeve të blerjes;

iii. tarifat për dhënien me qira të frigoriferëve;

iv. tarifat e shërbimeve të tregut të shitjes me shumicë;

v. rregulloren e tregut, duke sugjeruar edhe ndryshime;

vi. organizimin e personelit të nevojshëm për funksionimin e shërbimeve të tregut dhe për çdo ndryshim të këtij organizimi;

vii. çdo çështje tjetër lidhur me aktivitetet në treg.

2. Pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor të Tregut është pa shpërblim.

Neni 5
**Drejtori i tregut**

1. Drejtori i tregut emërohet dhe shkarkohet nga DSHPA-ja, me propozim të Komitetit Këshillimor. Ai zgjidhet nga radhët e profesionistëve të fushave të peshkimit dhe akuakulturës, drejtësisë dhe ekonomisë, me eksperiencë pune të paktën 5 vjet në profesion.

2. Drejtori është përgjegjës për funksionimin e rregullt të tregut dhe shërbimeve, organizimi i të cilit do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai drejton, mbikëqyr dhe cakton detyrat për secilin punonjës, cakton turnet dhe orët e punës.

3. Drejtori i tregut kryen detyrat e mëposhtme:

a) konstaton plotësimin e kushteve për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit;

b) mbikëqyr kohën e hapjes dhe mbylljes së tregut;

c) siguron që operacionet e furnizimit të tregut të mos pengohen;

ç) siguron që të gjitha transaksionet e blerjes dhe shitjes janë kryer sipas ligjeve dhe rregulloreve;

d) autorizon në raste të jashtëzakonshme futjen dhe daljen e produkteve ushqimore përtej kohës së caktuar;

dh) propozon, me sugjerimin e operatorëve, nismat që synojnë favorizimin e furnizimit të tregut me produkte, zgjerimin e sipërfaqes së nevojshme për shitje;

e) verifikon faktin që mallrat dhe ambalazhet përputhen me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

ë) verifikon, me kërkesë të palëve të interesuara ose kryesisht, cilësinë e produktit dhe dokumentacionin shoqërues;

f) është përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrave të lënë nga inspektori i ngarkuar për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në treg;

g) siguron mospërdorimin e praktikave mashtruese lidhur me peshën e produktit apo të çdo praktike tjetër që mund të përdoret nga tregtarët;

gj) rregullon inspektimet gjatë orarit të mbylljes së tregut dhe veçanërisht natën;

h) në raste urgjente, merr masat e nevojshme për të cilat raporton te menaxheri i tregut;

i) siguron pajisjet e duhura për të mundësuar ruajtjen e mallrave në treg;

j) miraton akte brenda përgjegjësive të tij, në funksion të mirorganizimit të tregut;

k) siguron që veprimtaria e tregtarëve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

l) kujdeset për ushtrimin e kontrollit veterinar dhe higjieno-sanitar të produkteve të peshkimit në përputhje më legjislacionin në fuqi;

ll) kujdeset për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë zhvillimit të ankandit.

4. Brenda 30 ditëve nga lindja e mosmarrëveshjeve sipas shkronjës "ll", të pikës 3 të këtij neni, palët e interesuara kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, pranë drejtorit të tregut. Drejtori, brenda 30 ditëve, shqyrton pretendimet e tyre dhe vendos mbi to.

Neni 6
**Personeli tjetër i tregut**

1. Drejtori i tregut të Shëngjinit, për të siguruar mirëfunksionimin e këtij tregu të shitjes së produkteve peshkore me shumicë ndihmohet edhe nga personeli i mëposhtëm:
a) shërbimi i pastrimit të tregut;
b) shërbimi i arkës;
c) shërbimi i ruajtjes;
ç) çdo shërbim tjetër ndihmës në treg.

Neni 7
**Marrja e të dhënave statistikore dhe çmimet**

1. Në treg grumbullohen të dhëna për sasitë dhe çmimet e shitjes së produkteve të kontraktuara, sipas kreut XII, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 256, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit".
2. Dokumenti bazë për grumbullimin e të dhënave është fleta e ankandit, e cila, ndër të tjera, përmban informacionin e mëposhtëm:
a) llojet, cilësinë dhe sasinë;
b) origjinën;
ç) bleresin.
3. Produktet e përziera lejohen vetëm nëse produkti është në të vërtetë i ofruar në treg si i tillë, edhe pse mbetet detyrimi për specifikimin e llojeve.
4. Të dhënat personale u nënshtrohen rregullave në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa të dhënat e tjera, si për çmimet ashtu edhe për llojet, cilësitë dhe sasitë, janë objekt publikimi.
5. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dërgon çdo muaj, pranë ministrisë të dhënat e grumbulluara të muajit paraardhës.

Neni 8
**Fleta e ankandit**

1. Fleta e ankandit përgatitet nga drejtori i tregut dhe përmban informacionet si në vijim:
a) kodin e identifikimit të prodhuesit;
b) NIPT-in;
c) origjinën e mallit;
ç) numrin e arkave dhe peshën neto;
d) listën e secilës shitjeje (duke specifikuar llojin e specieve, cilësinë, peshën dhe çmimin).
2. Fleta e ankandit nuk zëvendëson faturën tatimore të shitjes.
3. Modeli i fletës së ankandit gjendet në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 9
**Tarifat**

1. Tarifat e shërbimit përllogariten nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, duke marrë mendimin edhe të Komitetit Këshillimor dhe i propozohen për miratim ministrit përgjegjës për peshkimin.
2. Tarifat kanë për qëllim mbulimin e shërbimeve që ofrohen në treg dhe përbëhen nga:
a) tarifa për përdorimin e mjediseve të përbashkëta, pajisjeve të tregut, pastrimit, akullit;
b) tarifa për shërbimin e ankandit;
c) tarifa për shërbimin veterinar;
ç) tarifa për shërbimin e ngarkim shkarkimit.
3. Tarifat e miratuara janë të shpallura, nën kujdesin e drejtorit të tregut, në vende të përshtatshme dhe sidoqoftë në të gjitha pikat e shitjes.
4. Tarifat përllogariten mbi bazën e numrit të arkave të kaluara në treg dhe paguhen në momentin e daljes së mallit.
5. Tarifa e akullit paguhet veçmas.

Neni 10
**Oraret dhe kalendari**

1. Orari dhe kalendari hartohen nga drejtori i tregut duke marrë dhe mendimin e Komitetit Këshillimor dhe shpallen në hyrje të tregut.
2. Drejtori i tregut mund, në raste të veçanta, të vonojë ose shpejtojë hapjen ose mbylljen e shitblerjeve.

Neni 11
**Dhënia në përdorim e magazinave dhe dhomave frigoriferike**

1. Magazinat dhe dhomat frigoriferike, që janë pjesë e tregut të Shëngjinit, i jepen me qira operatorëve që bëjnë kërkesë nëpërmjet një

marrëveshjeje të veçantë me DSHPA-në, sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë mendimin edhe të Komitetit Këshillimor.

2. Për dhënien e magazinave dhe dhomave frigoriferike duhet të jenë të fiksuara nga ana e DSHPA-së, aktiviteti minimal vjetor. Mosarritja e këtyre niveleve minimale mund të çojë në heqjen e së drejtës së përdorimit të këtyre ambienteve ose transferimin në magazina ose dhoma frigoriferike me dimensione më të vogla në momentin e skadimit të kontratës.

3. Niveli minimal mund të ulet ose mund të quhet i pavlefshëm kur kemi të bëjmë me forca madhore të paparashikuara dhe që kanë penguar ose reduktuar në mënyrë objektive aktivitetin e operatorit.

4. Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve janë tarifat që përcaktohen në VKM-në nr. 54, datë 5.2.2014, "Për përcaktimin e kritereve dhe mënyrave të dhënies me qira ose enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Neni 12

**Kushtet higjieno-sanitare**

Në tregun e Shëngjinit zbatohet plani i autokontrollit të bazuar mbi HACCP-në (*Hazard Analysis and Critical Control Points*), me qëllim që të garantojë sigurinë ushqimore të produkteve të peshkimit.

Neni 13

**Malli në shitje dhe tërheqja e prodhimit**

1. Shitësi është i detyruar të sistemojë prodhimet peshkore sipas dispozitave të lëshuara nga drejtoria e tregut dhe nga veterineri i tregut.

2. Shitësve u njihet e drejta të tërheqin nga tregu prodhimet e sjella pa i paguar kësaj të fundit asnjë lloj detyrimi të çfarëdolloj natyre.

3. Tërheqja e prodhimit nga tregu mund të ndalohet nga veterineri për arsye të karakterit higjieno-sanitar.

Neni 14

**Qarkullimi i automjeteve**

1. Qarkullimi dhe qëndrimi i automjeteve për ngarkimin dhe shkarkimin e prodhimeve të peshkut rregullohen nga drejtori i tregut me një urdhër të brendshëm.

2. Përdorimi i mjeteve të transportit të mallrave brenda tregut për veprimet e lëvizjes së mallit autorizohet nga drejtori i tregut.

Neni 15

**Rregulla të brendshme**

1. Në treg dhe në zonat pranë saj ndalohet:

a) bllokimi i vendkalimeve me mbeturina ose sende të tjera ose sidoqoftë pengimi i qarkullimit;

b) asistimi në proceset e përpunimit ose trajtimeve të tjera të prodhimit pa pasur veshjet e posaçme të shërbimit të pastra;

c) tërheqja e blerësve me thirrje ose zhurma të ndryshme;

ç) futja e qenve;

d) ndezja e zjarreve;

dh) prishja e rregullit dhe disiplinës së tregut ose e shitblerjeve;

e) prekja e mallit para dhe gjatë blerjes nga ana e personave jo të autorizuar;

ë) pirja e duhanit, ngrënia dhe pirja alkoolike;

f) hyrja në sallën e ankandit e personave që nuk përfshihen në operacionet e tregut përveç atyre të autorizuara nga drejtori i tregut.

2. Tregtarët dhe personeli tjetër ndihmës mund të shpallin në vendet e caktuara njoftime me karakter sindikal pas miratimit të drejtorit të tregut.

Neni 16

**Përgjegjësitë**

1. Me përjashtim të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, DSHPA-ja nuk merr asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji për dëmtime, humbje ose prishje të prodhimit ose gjërave që mund t'u ndodhnin operatorëve ose frekuentuesve të tregut.

2. Operatorët, punëtorët dhe frekuentuesit e tregut janë përgjegjës për demet që ata ose vartësit e tyre u shkaktojnë pajisjeve, impianteve dhe lokaleve të tregut ose sidoqoftë entit administrues.

Neni 17

**Masa disiplinore dhe administrative**

1. Shkelja e parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe të vendimeve bëjnë që në ngarkim të personave përgjegjës të veprojnë masa disiplinore

dhe administrative që sipas rëndësisë së shkeljes ose përsëritjes ndahen në:

a) paralajmërim (verbal ose me shkrim) ose pezullim të fajtorëve nga çdolloj aktiviteti në treg, për një periudhë maksimale prej tri ditësh, nga ana e drejtorit të tregut;

b) pezullim nga çdo aktivitet i tregut për një kohëzgjatje maksimale prej tre muajsh të dhënë me vendim nga Komiteti Këshillimor i Tregut, pasi ka dëgjuar edhe fjalën e të interesuarit. Në rastet e rënda dhe urgjente ky pezullim mund të jepet edhe nga drejtori i tregut.

2. Masat e pezullimit për më shumë se tri ditë të dhëna nga drejtori i tregut duhet t'i komunikohen menjëherë Komitetit Këshillimor të Tregut dhe humbasin vlefshmërinë e tyre në rast se nuk miratohen brenda tri ditëve nga ky komitet.

Neni 18

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**Milva Ekonomi**

Shtojca 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
TREGU I SHËNGJINIT

Për.....................................................

Monitor i zonës.....................................................

FLETA E ANKANDIT

| **Të dhënat e anijes** | | **Të dhënat e shitjes** | |
|---|---|---|---|
| Emri | ..................................................... | Data | ..................................................... |
| Numri NFR | ..................................................... | Shteti | ..................................................... |
| Nr. identifikimi i jashtëm | ..................................................... | Vendi | ..................................................... |
| Porti i regjistrimit | ..................................................... | Shitësi (emri) | ..................................................... |
| Kapiteni i anijes/përdoruesi/emri | ..................................................... | Blerësi (emri) | ..................................................... |
| | | NIPT (blerësit) | ..................................................... |
| **Të dhënat e prodhimit** | | Nr. i referimit të kontratës* | ..................................................... |
| Data e zbarkimit | ..................................................... | Data dhe numri i faturës | ..................................................... |
| Porti i zbarkimit | ..................................................... | Nr. i ref. marrë në ngarkim | ..................................................... |
| Zënie të tërhequra nga OP-ja | ..................................................... | Nr. i ref. dokumentit transportit* | ..................................................... |

Llojet

| Emri (kodi FAO) | Zona gjeografike (kodi FAO) | Pesha kg | Çmimi/kg | Çmimi total | Nr. i arkave | Kat. freskisë | Cilësia | Paraqitja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

* Nëse aplikohet.

Tarifa = nr. i arkave x 50 lekë = __________ lekë

Nr. i faturës: ____________________

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 117
Datë: 2021/07/26 15:08:47
0af829dc-fd8c-461f-b800-81f502653e6a

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë